



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 2665/2022
Data: 12.04.2022

PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tretë -III- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 22.03.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetari i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh për Administratë), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Abdurraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021.
3. Raporti i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021.
4. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2021.
5. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Raporti i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- kur do të shpallet konkursi për pranimin e anëtarëve të komiteteve konsultative.

Kryesuesi thekson:-konkursi për komitete konsultative do të shpallet në këtë javë. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KATËR KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- këshillit komunal për siguri në bashkësi në vitet paraprake ka mbajtur takim për çdo muaj kurse tash takimi mbahet çdo dy muaj.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA NJOFTIMI PËR AKTIVITETE E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- këshillat e fshatrave nuk kanë paraqitur raport për shkak se ju ka skaduar mandati dhe në mbledhjen e fundit të kuvendit të komunës e kemi formuar komisionin për zgjedhjen e këshillave të fshatrave. Nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kemi marr konfirmimin që vendimi i komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave është i ligjshëm që do të thotë mund të fillojmë procedurat.

Sherif Berisha thekson:-vitet e kaluar kur ishit në opozitë a i keni votuar këto pika të rendit të punës.

Kryesuesi thekson:- po i kemi votuar dhe vetë kam qenë administratorë i fshatit dhe mandati na ka kaluar në vitin 2019, mirëpo për me u zgjedhur për shkak të kovidit nuk kemi mundur, mirëpo tash besoj që do të fillojnë procedurat për zgjedhjen e administratorëve të rinj por tash do të jetë më ndryshe se do të jenë vetë katër këshilla të fshatrave. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA PËR AKTIVITETE E KËSHILLAVE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- për te shëndetësia kemi diskutuar çështjen e stomatologut a është ndërmarr diçka për këtë çështje. Kam pasur disa vizita te QKMF-ja dhe është mirë me rishikuar çështjen e punëtorëve aty sepse kemi pasur vërejtje edhe më herët por të njëjtat probleme janë edhe tani për shkak se punëtorët nuk qëndrojnë në vendet e punës dhe rrinë nëpër zyre ashtu siç kanë ndejtur. Si qëndron puna e rëntgenin për shkak se shkon pacienti me bërë fotografimin dhe i thuhet që të vijë pas tri dite.

Refet Kalisi thekson:- pse nuk është në funksion rëntgeni në QKMF.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- çështja e stomatologut është problem çështja e pozitës që është nxënë në QKMF për shkak se janë 32 pozita në QKMF dhe të gjitha janë të zanura. Me statut është e paraparë edhe pozita e stomatolog por është nxënë me pozitën e farmacistit, mirëpo kemi parashtruar në Ministri kërkesë të veçantë për me u shtuar numri i stafit por se sa do të realizohet mbetet të shihet. Nëse nuk realizohet kërkesa në Ministri atëherë do të mundohemi me kontratë në vepër por duke i shikuar mundësitë buxhetore për këtë çështje. Sa i përket papërgjegjësive të stafit nuk jam në dioni por do të interesohem për këtë çështje. Rëntgeni nga muaji dhjetorë është jo funksional për shkak të defektit të cilin e ka por në momentin që është lëshuar buxheti i kemi filluar procedurat e tenderimit për me rregulluar

Sherif Berisha thekson:- për çështjen e barnave me afat të skaduar a keni ndërmarr diçka.

Sevdi Dernjani thekson:- për këtë çështje kemi bërë shkresë në Ministri të Shëndetësisë dhe zëvendës Ministria e ka rekomanduar te sekretari, mirëpo sekretari e ka dërguar një grup të farmacistëve dhe e kanë parë gjendjen, i kanë dhënë rekomandimet për situatën aktuale për me formuar një komision. Barnat duhet të hiqen prej atij objekti, duhet të gjendet një lokacion për me bërë numërimin e barnave të cilët janë me afat të skaduar. Pasi të bëhet numërimi i barnave me udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë do të bëhet asgjësimi i tyre ku është pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë. Ua kemi shpjeguar rastin që është situatë shumë e rëndë dhe i pamundëson punimet në atë objekt sepse nuk e di kush e ka dhënë urdhrin për me i vendosur aty për shkak se është objekt adekuat, nuk i plotëson kriteret.

Sherif Berisha thekson:- për këtë problem është bërë shumë zhurmë sepse mediatikisht është potencu që keni inxhizime dhe ju keni bërë akuza që ka inxhizime që është bërë keqpërdorime me këto barna dhe si opozitë ju përshëndesim në këtë drejtim nëse ka keqpërdorim të kësaj natyre.

Sevdi Dernjani thekson:- nuk jemi për me fshehur asnjë keqpërdorim por situata aktuale është kjo që ka një deponi me barna me afat të skaduar të panumëruara dhe në moment që bëhet lista me barnat me afat të skaduar do të i dërgohet Ministrisë, ndërsa për çështje të përgjegjësive i mbetet Ministrisë se si do të vendosë.

Refet Kalisi thekson:- i keni bërë katër muaj qeverisje dhe pasi është kaq rrezik është dashur me bërë zgjidhje për këtë çështje .

Sevdi Dernjani thekson:- është rekomandim i Ministrisë që nuk guxon me i prekë barnat sepse na i ka sugjeruar procedurat të cilat duhet me i ndjekur. U potencua për neglizhencën në QKMF ndoshta mund të jetë e vërtetë por kur të përmendet papërgjegjësia e punëtorëve, është mirë me najë dokumentuar, me najë faktuar për shkak se është edhe në të mirën e qytetarëve por edhe në të mirën tonë .

Sherif Berisha thekson:- nuk është vetëm sa për me fol por i kam parë vetë, e di që e kanë orarin e pushimit por nuk kanë mundësi me lënë vendin e punës pa shërbime, por ka raste që kam qenë edhe jashtë pushimit dhe pesë apo gjashtë motra pinë kafe, ndërsa ato të rejtat ngajnë për me kryer punë nuk është në rregull se ata janë në trajnim. Po flitet se nuk ka zyre unë them që ka por janë mbyllur dhe drejtoresha duhet me i shikuar.

Kryesuesi thekson:- për çështje të barnave nuk jemi vetëm ne si Hani i Elezit të cilin e kemi këtë problem por edhe më herët kanë tentuar për me bërë asgjësimi por një pjesë e fajit më të madh duhet ta ketë Ministria e Shëndetësisë për shkak se shumë herë është ndërmarr me bërë diçka ato e kanë neglizhuar . Drejtoresha e Shëndetësisë tash së bashku me kryetarin e komunës kanë ndërmarrë hapa dhe besoj që kësaj radhe ka me u përmbyll ai problem sepse është një shqetësim edhe te punëtorët të cilët punojnë aty. Si trevë flitet shumë për ato barna por nuk na lejohet me kryer punën ashtu siç duhet me bërë . Sa i përket çështjes së rëntgenit mendoj se është neglizhencë nëse i thuhet pacientit që të vijë pas tri dite dhe unë mendoj që duhet të ketë arsye për me i thënë pacientit.

Sherif Berisha thekson:- çështja e rëntgenit nuk ka të bëjë në këtë periudhë por më herët. Veturat e komunës të cilat i pastrojnë te kompania “Alba” si është e rregullime.

Natyra Kalisi thekson:- është kontrata që është zhvilluar me procedura të prokurimit për pastrimin e veturave zyrtare, kontrata ka ende afat.

Refet Kalisi thekson:- a është bërë alokimi i mjeteve financiare për mallra dhe shërbime.

Lindita Ballazhi thekson:- po është bërë alokimi i mjeteve.

Sherif Berisha thekson:- dje ka qenë ditë pranvere por dit edhe për sindrom daun për personat me nevoja të veçanta, ndërsa ekzekutivi shkon dhe e viziton një afaristë, mirëpo mendojë që dita që ka qenë nuk përputhet me vizitën. Në të gjitha komunat sa kam mundur me vërejt ka qenë ditë e shënuar për personat me nevoja të veçanta, ndërsa në komunën tonë nuk është mbajtur asnjë aktivitet.

Majlinda Kaloshi thekson:- sa i përket vizitës që kemi pasur te biznesi ka qenë takim që e kemi caktuar më herët për shkak se dihen angazhimet e Kryetarit të Komunës se ka obligime më shumë dhe nuk do të thotë që është bërë me qëllim për me anashkaluar ditën botërore të sindromat daun. Sa i përket aktiviteteve dje kemi biseduar me drejtorin e arsimit për aktivitet që kanë me u zhvilluar nëpër shkolla por më konkretisht mund të na njofton drejtori i arsimit.

Kryesuesi thekson:- asamblistët të cilat janë në kuvend është mirë që ta formojnë grupi i grave kuvendi komunal pra duhet ta zgjedhin një kryesuese. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka e shpallim të mbyllur mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:39.

Procesmbajtësi

Avni Bushi

